

**Fusha:** Shoqëria dhe mjedisi

**Lënda:** Gjeografi

**Shkalla:** V

**Klasa:** XI-C

**Tematika:** Proceset natyrore dhe shoqërore

**Nëntematika:** Litosfera

**Tema mësimore:** Shkëmbinjtë sedimentar dhe metamorfik

**Situata e të nxënit:** Bashkëbisedim, sjellja e shembujve dhe reflektim i nxënësve.

**Rezultatet e të nxënit sipas kompetencave kyçe:**

Kompetenca për jetën sipërmarrjen dhe mjedisin: Diskuton në grup për rëndësinë ekonomike që ka shfrytëzimi i mineraleve dhe shkëmbinjve magmatik, sedimentar dhe metamorfik.

**Kompetenca qytetare:**

- Manifeston tolerancë ndaj mendimeve të tjerëve.
- Demonstron bashkëpunim dhe qëndrim etik gjatë punës në grup.

**Rezultatet e të nxënit të temës mësimore**

**Nxënësi/sja**

- Përshkruan kuptimin e termit shkëmb sedimentar, metamorfik;
- Dallon karakteristikat e shkëmbinjve sedimentarë sipas kushteve të formimit;
- Zbulon proceset kryesore që shkaktojnë formimin e shkëmbinjve metamorfikë;
- Ndërton skemën e formimit të shkëmbinjve sedimentarë.

**Fjalë kyçe:** shkëmbinjtë sedimentarë, metamorfikë, sediment, diagjonezë.

<b>Çështja</b>	<b>Di</b>	<b>Dua të di</b>	<b>Mësoj</b>
Shkëmbinjtë sedimentarë	Di që shkëmbinjtë sedimentarë formohen nga sedimenti, ngjeshja dhe litifikimi i detriteve dhe copave në basenet ujore.	Cilat janë karakteristikat e shkëmbinjve sedimentarë sipas origjinës së formimit të tyre?	Mësova skemën e ndërtimit të shkëmbinjve sedimentarë. Shk. Sedimentarë, copëzorë, kimik dhe organogjen, argjilorë
Shkëmbinjtë metamorfik	Që mermeri është shkëmb metamorfik	Si formohen shkëmbinjtë metamorfik?	Shkëmbinjtë metamorfik formohen nga shndërrime në temperaturë dhe trysni të lartë të shkëmbinjve magmatikë dhe sedimentarë në brendësi të kores së tokës. Mermeri formohet nga metamorfizmi i gëlqeres.
Rëndësia e mineraleve dhe e shkëmbinjve	Shkëmbinjtë dhe mineralet kanë përdorim të gjerë në ndërtim	Si ndikojnë shkëmbinjtë në mjedis?	Përdorimi i mineraleve në degë të ndryshme si: përdorimi i kuarcit, silicit, bakrit etj. Rëndësia e shkëmbinjve për formimin e dherave, karakterit të veçantë të relievit, hidrografisë. Si dhe mineralet e dëmshme si amianti (azbest).

Udhëzohen nxënësit të vizatojnë skemën me tre kolona në fletoret e tyre në klasës.

Pas kësaj u caktohet detyra për të lexuar çështjet e temës:

- 1- Shkëmbinjtë sedimentarë
- 2- Shkëmbinjtë metamorfik
- 3- Rëndësia e mineraleve dhe e shkëmbinjve

Në kolonën “**Dua të di**” shkruhen pyetje ose kërkesa të shkurtra për njohuritë shtesë.

Në kolonën “**Mësoj**” shkruhen informacionet e reja që u fituan.

Pas përfundimit të leximit dhe plotësimit të çdo kolone vjen momenti kur mësuesi/ja zhvillojnë biseda dhe diskutime të lira, krijojnë minisituata problemore, përshkruajnë në mënyrë artistike peizazhet e natyrës shqiptare etj.

### **Përforcimi**

Demonstrohen para klasës disa foto të shkëmbinjve sendimentarë dhe metamorfikë.

U kërkohet nxënësve të zgjedhin një nga këto foto dhe të krijojnë përshkrime të lira dhe, mundësisht, origjinën e formimit dhe përdorimit të tyre.

### **Vlerësimi dhe detyrat**

- a. Vlerësohen nxënësit për pjesëmarrjen në mësim dhe për paraqitjen e fakteve të reja.
- b. Jepet detyra për grumbullimin e materialeve ( nga TIK, revistat, librat, fletëpalosjet etj.) për dëmet që shkakton përdorimi i Eternitit.

**(Përgatiti: Klementina Ngjeci, mësuese në shkollën “Skënderbeu”, Krumë)**